



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:264715
Datë: 26.04.2023
Numri i dokumentit: 04223200

Ka. nr. 153/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Azra Cakolli kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurës Subjektit ekonomik “Ex -Fis”, SHPK, me seli në fshatin Vrellë - Komuna e Lipjanit, me NUI: 810536998, me drejtor Lum Muhaxheri, të cilën e Përfaqëson Nebih Troshupa, avokat nga Lipjani, për shkak të veprës kundërvajtëse nga neni 15 të Ligjit Nr. 08/L-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme, neni 19 par. 13 pika 13.1 si dhe për kundërvajtje nga neni 26 sanksionuar me nenin 137 të Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorëve, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga ana e ushtruesit të Kërkesës - MINT-së, Inspektorati i Tregut, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K. nr. 1379/2022, të datës 23.03.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe neni 78, konform të nenit 143 par. 1 dhe par. 2 të Ligjit për Kundërvajtje, Nr. 05/L-087, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 25.04.2023, morri këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si pjesërisht e bazuar ankesa e paraqitur nga Ushtruesi i Kërkesës - ankesës MINT - Inspektorati i Tregut, ndërsa

II. NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan - Divizioni i Kundërvajtjes, K. nr. 1379/2022, i datës 23.03.2023, sa i përket gjobës së shqiptuar, ashtu që ndaj të pandehurit Subjektit afarist “Ex -Fis”, SHPK, me seli në fshatin Vrellë - Komuna e Lipjanit, për kundërvajtjen nga neni 15 par. 2 dhe 3 sanksionuar me nenin 19 par. 13 pika 13.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme, konform nenit 35 të LK-së, i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej **2000(dymijë)€**, të cilën ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e caktuar e njëjta do të arkëtohet me dhunë sipas Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

III. PEZULLOHET procedura ndaj subjektit afarist “Ex -Fis”, SHPK, me seli në fshatin Vrellë - Komuna e Lipjanit, për kundërvajtjen nga neni 26 të Ligjit Nr. 06/L-034, sanksionuar me nenin 137 të Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorëve, konform nenit 126 par. 2 të LK-së.

Në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i njëjtë.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

gjykata e shkallës së parë me aplikim të nenit 35 të LK-së, në shumë prej 200€, nuk është adekuate me shkallën e përgjegjësisë, peshën, rrezikshmërinë dhe pasojat, andaj vendimi mbi dënimin ka mbetur i pa bazuar në prova bindëse të cilat do të mund të arsyetonin shqiptimin e dënimit në shumë prej 200€, e po ashtu kundërvajtja nga neni 26 të Ligjit Nr. 06/L-034, sanksionuar me nenin 137 të Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorëve, nuk ka të bënë me tejkalimin e marzhës tregtare të përcaktuar me Vendim të Qeverisë, por ka të bëjë vetëm me Rregullimin e çmimeve të shitjes dhe çmimeve për Njësi, andaj gjykata konform nenit 126 par. 2 të LK-së, e ka pezulluar procedurën për këtë kundërvajtje ndaj të pandehurës "Ex -Fis", SHPK.

Si rrjedhojë e të cekurave më lartë Kolegji e NDRYSHOJ aktgjykimin e goditur, vetëm sa i përket gjobës së shqiptuar, ashtu që të pandehurit Subjektit Ekonomik – person juridik "Ex -Fis", SHPK, nga neni 15 par. 2 dhe 3 sanksionuar me nenin 19 par. 13 pika 13.1 të Ligjit Nr. 08/L-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme, për të cilën kundërvajtje parashihet dënimi prej 2000 – 6.000€ për personin juridiku, konform nenit 35 të LK-së, i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 2000(dymijë)€, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, peshën, rrezikshmërinë, pasojat e veprës së kryer, duke konsideruar se me gjobën e shqiptuar tani do të arrihet qëllimi i ndëshkimit ashtu që i pandehuri në të ardhmen të mos kryej vepra kundërvajtëse të njëjta apo të ngjashme.

Në vështrim të nenit 143 par. 1 dhe par. 3 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Ka. nr. 153/2023, me datë 25.04.2023



KRYETARJA E KOLEGJIT,

Azra Cakolli

[Signature]